FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

VITAMINE B KOMPLEKS

Drazhe - (5 mg / 2 mg / 2 mg / 30 mg)
(Tiaminë klorhidrat, Piridoksinë klorhidrat, Riboflavin, Nikotinamid)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues do të lexoni:

1. Çfarë është Vitamine B kompleks dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Vitamine B kompleks
3. Si ta merrni Vitamine B kompleks
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Vitamine B kompleks
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË VITAMINE B KOMPLEKS DHE PËRSE PËRDORET

Vitamine B kompleks merr pjesë në metabolizmin e karbohidrateve, yndyrnave dhe proteinave. Pamjaftueshmëria e ndonjërës prej këtyre vitaminave ose rritja e nevojave për to, shkakton një kërkesë më të madhe për të gjithë vitaminat e këtij grupi.
Vitamine B kompleks – drazhe përdoret në:

- profilaksinë dhe mjekimin e hipovitaminozës B dhe të avitaminozës;
- rritjen e nevojave për vitaminat e kompleksit B (si p.sh.: rritja dhe zhvillimi i fëmijëve, periudha e shtatzënisë dhe e ushqyerjes së fëmijëve me gji);
- çrregullimet e përthithjes së vitaminave në sëmundje të ndryshme të aparatit tretës dhe në sëmundje të mëlçisë;
- beriberi;
- neuralgji;
- polineurit;
- neurodermatoza.

2. PËRPARA SE TË MERRNI VITAMINE B KOMPLEKS

Mos merrni Vitamine B kompleks dhe pyesni mjekun tuaj në qoftë se:

- keni mbindjeshmëri të njohur ndaj kompleksit të vitaminave B ose ndaj përbërësve të tjerë të drazhesë;
- keni hipervitaminozë të vitaminave të veçanta.

Tregoni kujdes të veçantë me Vitamine B kompleks
Konsultohuni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni Vitamine B kompleks. Gjatë përdorimit të Vitamine B kompleks, urina mund të marrë ngjyrë portokalli ose të verdhë të ndritshme për shkak të pranisë së riboflavinës.

Marrja e barnave të tjera
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Vitamine B kompleks.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë edhe ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Vitamine B kompleks në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit, sepse përdorimi i njëhershëm i Vitamine B kompleks dhe i levodopës mund të shkaktojë uljen e efektit të kësaj të fundit (për shkak të piridoksinës).

Shtatzënia dhe ushqimi me gji
Kërkoni këshillën e mjekut ose të farmacistit tuaj përpara se të merrni këtë bar.

Shtatzënia
Rreziku në shtatzëni: Kategoria C.
Deri tani nuk janë kryer studime në shtatzëni, tek njerëzit apo kafshët. Rekomandohet që të merret vetëm kur përfitimet për nënën janë më të mëdha se risqet për fetusin.

Ushqimi me gji
Një pjesë e përbërësve të Vitamine B kompleks kalojnë në qumështin e gjirit. Ndiqni rekomandimin e mjekut nëse duhet apo jo të merrni Vitamine B kompleks gjatë ushqimit me gji.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Vitamine B kompleks nuk ndikon në aftësinë për të drejtuar automjetin. Për këtë arsye mund të merret pa problem nga pacientët.

Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Vitamine B kompleks
Ky bar përmban laktozë dhe sukrozë. Në qoftë se keni intolerancë ndaj disa sheqernave, kontaktoni me mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar.

3. SI TA MERRNI VITAMINE B KOMPLEKS

Gjithmonë merreni Vitamine B kompleks sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose me farmacistin tuaj.
Në qoftë se ndjeni që efektet e Vitamine B kompleks janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose me farmacistin tuaj.
Tabletat duhet të merren nga goja me të paktën një gotë ujë (250 ml ujë).
Ju këshillojmë që të mos merrni pije alkoolike gjatë kohës që merrni këtë bar.

Dozimi:
Të rriturit: 1 – 2 drazhe, 2 – 3 herë në ditë.
Fëmijët nga 5 deri 14 vjeç: 1 drazhe, 1 herë në ditë.

Në qoftë se keni marrë më shumë Vitamine B kompleks
Nuk ka të dhëna për mbidozimin nga Vitamine B kompleks.
Në qoftë se keni marrë më shumë Vitamine B kompleks se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Vitamine B kompleks
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Vitamine B kompleks mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston ato.
Vitamine B kompleks shfaq efekte anësore në raste tepër të rralla dhe në personat e ndjeshëm. Tek këta persona mund të shfaqen reaksione mbindjeshmërie.
Gjatë mjekimit me Vitamine B kompleks urina mund të marrë ngjyrë portokalli ose të verdhë të ndritshme (për shkak të riboflavinës).
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI VITAMINE B KOMPLEKS

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Vitamine B kompleks pas datës së skadencës e cila është shënuar në paketim.
Ruajeni nën temperaturën 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe nga lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Vitamine B kompleks
Lëndët vepruese janë: tiaminë klorhidrat, piridoksinë klorhidrat, riboflavin dhe nikotinamid.
Çdo drazhe përmban 5 mg tiaminë klorhidrat, 2 mg piridoksinë klorhidrat, 2 mg riboflavin dhe 30 mg nikotinamid.
Përbërësit e tjerë janë: pantotenat kalçiumi, celulozë mikrokristalore, laktozë, stearat magnezi, glikolat natriumi i amidonit, xhelatinë, talk, povidon, karbonat kalçiumi, dioksid titani, sukrozë, Opalux portokalli, Opaglos i bardhë 6000.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 30 ose 60 drazhe.

Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:

Mund të merret pa recetën e mjekut.

Përmbajtja. Kujdes.

Forma e tabletës.

Mbajtësi i autorizimit të tregtimit (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Korrik 2012.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.